

Raport nga kampi veror për të rriturit me aftësi të kufizuar të ndryshme (grupi i III) "Ulqini 2006"

Nga 31 gusht – 11 shtator 2006

Mbështetur dhe financuar nga Onlus R. Bazzoni



Organizuar nga HandKOS`i

Personeli:

Përgjegjës i kampit: Rexhep Kuqi

Asistent i përgjegjësit: Jakup Vitia

Teknike mjekësor dhe koordinator i aktiviteteve: Muharrem Ceji

Pjesëmarrësit: 46 persona

Për dallim nga grupi i parë (fëmijët) dhe grupi i dytë (personat me lëndime të palcës kurrizore), në këtë grup pjesëmarrja ka qene nga shoqata dhe persona me aftësi të kufizuar të ndryshme.

Struktura e pjesëmarrësve sipas nivelit të aftësisë së kufizuar ka qenë kjo:

Nga shoqata e të verbërve 3,

Nga shoqata e te shurdhërve 3,

Nga Klubi "Dëshira" me aftësi të kufizuara mendore 4,

Me aftësi të ndryshme të kufizuar 31,

Shoqërues 4

- Stafi udhëheqës i grupit :

Përgjegjës i grupit ishte Regjep Kuqi i cili me profesion ishte mjek, ndërsa asistenti i përgjegjësit ishte Jakup Vitia, ndërsa Muharrem Cej ishte koordinator i aktiviteteve.

- Transporti:

Transporti u organizua me Autobus të kompanisë Shpejtimi Tours,

- Prezentimi i aktiviteteve (Dita e parë data 01 shtator 2006)

Ditën e parë përkatësisht me 1 shtator u bë prezentimi i qëllimit të kampit si dhe u dha një prezentim i shkurtër i historikut të donatorit të kampit (R.Bazzoni) dhe organizatorit të kampit (HandiKOS-it). Po këtë ditë pjesëmarrësve ju dhanë maicat me mbishkrimet e HandiKOS-it dhe R.Bazzonit si dhe ju shpërndanë paratë e xhepit.

Aktivitetet fizikale (Gjimnastika e mëngjesit) – 9,00 – 10,00

Aktivitetet e mëngjesit janë organizuar për çdo mëngjes ku pjesëmarrja e personave



ishte në nivel dhe udhëheqja e këtij aktiviteti ka shkuar në mënyrë rotative, duke filluar nga koordinatori i aktiviteteve dhe pastaj udhëhiqej edhe nga pjesëmarrësit tjerë nga shoqata e të shurdhërve etj.



- Plazhi dhe aktivitetet sportive 11,00 -17,00

Në plazh janë organizuar aktivitete të ndryshme si: futboll, volejboll etj. Personat të



cilët nuk dinin not u është asistuar nga personat tjerë të cilët e njihnin këtë sport. Vlen të theksohet se të gjithë personat të cilët kishin frikë nga uji filluan të notojnë falë asistencës së vazhdueshme të pjesëmarrësve tjerë.





- Seancat e Hapura – 18:30 – 19:00

Për çdo ditë pas orë 18:30 në oborrin e hotelit janë mbajtur seanca të hapura dhe diskutime rreth ligjeve të aplikueshme në Kosovë dhe RBB-së. Interesim të veçantë për



pjesëmarrësit ngjallnin ligji i pensioneve dhe ai i shëndetësisë. Pjesëmarrja në këto seanca ishte shumë aktive.

- Dalja në Qytet
Rekreacioni:

Dalja në qytet është bërë me veturën e HandiKOS-it, mirëpo shpesh personat organizoheshin dhe dilnin në qytet me vetëkontribut.

- Kujdesi shëndetësor:

Gjatë qëndrimit në kamp nuk keni pasur persona të cilët kanë kërkuar trajtim të veçantë përpos rasteve me djegie ku kami pasur një person me djegie më të rëndë ndërsa dy të tjerë me djegie më të lehta.